

**LIGJ**  
**Nr.8371, datë 9.7.1998**

**PËR LIDHJEN E TRAKTATEVE DHE MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**  
**Fusha e zbatimit të ligjit**

Ky ligj zbatohet për të gjitha traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga Republika e Shqipërisë.

**Neni 2**  
**Përkufizime**

Për qëllimet e kuptimit të këtij ligji:

- (a) "traktat" nënkupton një marrëveshje ndërkombëtare, kryesisht me karakter politik;
- (b) "ratifikim" nënkupton aktin me të cilin Kuvendi Popullor ose Presidenti i Republikës jep miratimin përfundimtar për një traktat ose marrëveshje ndërkombëtare, dypalëshe ose shumëpalëshe, të nënshkruar nga Republika e Shqipërisë;
- (c) "aderim" nënkupton aktin me të cilin Kuvendi Popullor ose Presidenti i Republikës jep miratimin që Republika e Shqipërisë të jetë palë në një traktat ose marrëveshje ndërkombëtare, e cila nuk është nënshkruar prej saj;
- (ç) "miratim në parim" nënkupton aktin me të cilin Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë miraton projektet e marrëveshjeve të paraqitura nga ministrinë përkatëse;
- (d) "miratim" nënkupton aktin me të cilin Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë miraton përfundimisht një marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe të nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;
- (dh) "plotfuqi" nënkupton një dokument që lëshohet nga një autoritet kompetent i shtetit ose i Qeverisë dhe që emëron një ose disa persona që e përfaqësojnë atë në zhvillimin e bisedimeve ose nënshkrimin e traktatit a marrëveshjes;
- (e) "rezervë" nënkupton një deklaratë të njëanshme, të bërë nga organi kompetent shtetëror, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, aderimit ose miratimit të një traktati ose marrëveshjeje me anën e së cilës ai synon të përjashtojë ose modifikojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara,
- (ë) "parafim" nënkupton aktin me të cilin personat e plotfuqishëm vënë inicialet për të treguar se kanë rënë dakord për tekstin përfundimtar të traktatit a të marrëveshjes;
- (f) "organizatë ndërkombëtare" nënkupton një organizatë ndërqeveritare;
- (g) "denoncim" nënkupton aktin me të cilin Kuvendi Popullor, Presidenti i Republikës ose Këshilli i Ministrave shpreh heqjen dorë nga një traktat ose marrëveshje ndërkombëtare;
- (gj) "ministri ose institucion qendror përkatës" nënkupton dikasterin, sfera e kompetencave të të cilit mbulon objektin e marrëveshjes.

### Neni 3

#### **E drejta për të lidhur traktate dhe marrëveshje**

Të drejtën për të lidhur traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare, dypalëshe ose shumëpalëshe, e kanë Presidenti i Republikës dhe Këshilli i Ministrave, sipas normave kushtetuese në fuqi.

Ministritë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit lokal kanë të drejtë të lidhin marrëveshje me karakter shkencor, kulturor, arsimor, teknik etj. brenda kuadrit të fushës apo juridiksionit të tyre, duke marrë më parë mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

### Neni 4

#### **Dhënia e plotfuqive**

Përfaqësuesit e shtetit, që ngarkohen të zhvillojnë bisedime dhe të nënshkruajnë traktate ose marrëveshje me përfaqësuesit e shteteve të tjera, ose që caktohen të shkëmbejnë instrumente ratifikimi apo të depozitojnë instrumente ratifikimi, aderimi ose denoncimi pranë një organizate ndërkombëtare apo pranë një shteti, pajisen me plotfuqi të rregullta. Gjithashtu, u jepet plotfuqi edhe përfaqësuesve të shtetit që marrin pjesë në sesionet e organizatave ndërkombëtare ose në konferenca të ndryshme ndërkombëtare dhe që ngarkohen të zhvillojnë bisedime dhe të nënshkruajnë traktate ose marrëveshje shumëpalëshe.

Plotfuqitë për përfaqësuesit e shtetit, që marrin pjesë në sesionet e organizatave ndërkombëtare ose në konferencat ndërkombëtare dhe që ngarkohen të zhvillojnë bisedime dhe të nënshkruajnë traktate ose marrëveshje dy ose shumëpalëshe, lëshohen përkatësisht nga Presidenti i Republikës, kur si subjekt i traktatit ose i marrëveshjes është shteti shqiptar dhe nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, kur si subjekt është Qeveria shqiptare.

Në çdo rast plotfuqitë e mësipërme kundërfirmohen nga Ministri i Punëve të Jashtme. Plotfuqitë për përfaqësuesit e shtetit, që ngarkohen të shkëmbejnë instrumente ratifikimi apo të depozitojnë instrumente ratifikimi a denoncimi pranë një organizate ndërkombëtare, lëshohen nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Në rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërministrore, plotfuqitë lëshohen nga titullari i dikasterit përkatës.

### Neni 5

#### **Iniciativa për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve**

Iniciativa për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe mund të merret nga shteti ynë ose nga shtetet e tjera.

Për marrëveshjet, ku si palë janë shtetet ose qeveritë dhe iniciativa është e palës sonë, ministritë përkatëse marrin më parë mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore të interesuara, para se t'i propozohet Këshillit të Ministrave lidhja e traktateve dhe marrëveshjeve.

Këshilli i Ministrave jep miratimin në parim për traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen në emër të shtetit ose të qeverisë.

### Neni 6

Kur iniciativa për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe merret nga shteti ynë, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse hartojnë tekstet e projekteve, për të cilat marrin mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë dhe të ministrive të interesuara.

Vërejtjet që mund të bëjë shteti tjetër, të cilat ndryshojnë përmbajtjen e projektit të palës

shqiptare ose kundërprojekti që mund të paraqitet nga ana e tij, pasi studiohen nga ministria ose institucioni tjetër qendror përkatës, i paraqiten Këshillit të Ministrave për miratim në parim, së bashku me mendimet e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore të interesuara, si dhe mendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Në rastet kur projekt marrëveshja që përgatitet nga pala jonë trajton probleme në kompetencë të dy a më shumë ministrive, faza përgatitore e saj drejtohet nga ministria, problemet e së cilës zënë vëllimin më të madh në marrëveshje.

Në rast mosmarrëveshjeje, për kompetencën e fazës përgatitore, është kabineti i Kryetarit të Këshillit të Ministrave që vendos se cila ministri duhet ta drejtojë këtë fazë.

Sipas procedurave të lartpërmendura mund të përgatiten dhe miratohen në parim edhe projekte-tip të marrëveshjeve.

#### Neni 7

Kur iniciativa për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe merret nga shteti tjetër, i cili i paraqet shtetit shqiptar projektet përkatëse, ministria ose institucioni qendror përkatës e studion këtë projekt dhe, sipas rastit, bën vërejtjet e saj ose harton kundërprojektin. Projekti i shtetit tjetër, së bashku me vërejtjet e palës shqiptare ose kundërprojekti i palës shqiptare i paraqiten për miratim në parim Këshillit të Ministrave, pasi të jetë marrë më parë mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i Ministrisë së Drejtësisë dhe i ministrive ose institucioneve të tjera të interesuara. Vërejtjet ose kundërprojekti i palës shqiptare, pasi miratohen, i dorezohen shtetit tjetër në rrugë diplomatike.

#### Neni 8

Në të gjitha rastet projekti i shtetit shqiptar, kundërprojekti ose vërejtjet që bëhen për projektin e paraqitur nga shteti tjetër hartohen në gjuhën shqipe dhe i dorëzohen shtetit tjetër. Projekti mund të dorëzohet së bashku me përkthimin në një gjuhë të huaj.

#### Neni 9

##### **Negocimi**

Kur shteti ynë dhe shteti tjetër arrijnë të sheshojnë mosmarrëveshjet kryesore në rrugë diplomatike, ata merren vesh se ku do të zhvillohen bisedimet dhe caktohet niveli i delegacioneve për adoptimin e tekstit përfundimtar të traktatit ose të marrëveshjes.

Projekt marrëveshjet me karakter teknik mund të lidhen me shkëmbim notash, pa zhvilluar bisedime me delegacione.

#### Neni 10

Para fillimit të bisedimeve, ministria, institucioni qendror ose organi i pushtetit lokal përkatës propozojnë nivelin e delegacionit të palës shqiptare, kohën dhe vendin ku do të zhvillohen bisedimet, pasi të jetë marrë më parë mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

#### Neni 11

Bisedimet zhvillohen nga të plotfuqishmit mbi bazën e projektit të shtetit shqiptar ose të projektit të shtetit tjetër, të ndryshuar në kuptimin e neneve 6 dhe 7.

Bisedimet mund të zhvillohen nga të plotfuqishmit edhe pa pasur një projekt paraprak. Në këto raste të plotfuqishmit shkëmbejnë mendimet, e tyre dhe ngarkojnë grupet e punës për

shqyrtimin e problemeve konkrete. Grupet e punës hartojnë bashkërisht një projekt, mbi bazën e të cilit do të zhvillohen bisedimet. Për këtë projekt merret miratimi në parim nga organet përkatëse.

Ndryshimet parimore, që mund t'i bëhen projektit gjatë zhvillimit të bisedimeve, miratohen nga Këshilli i Ministrave, para se të nënshkruhet teksti përfundimtar i traktatit ose i marrëveshjes. Për këto ndryshime merret më parë mendimi i ministrive dhe i institucioneve të tjera qendrore përkatëse dhe mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Kur palët vendosin që traktati ose marrëveshja të nënshkruhet në një datë të mëvonshme, të dy kopjet origjinale parafohen nga kryetarët e grupeve të punës të të dyja palëve që kanë zhvilluar bisedimet. Për këtë qëllim në çdo kopje origjinale vihen siglat e kryetarëve të grupeve të punës ose zëvendësve të tyre.

#### Neni 12

##### **Forma dhe gjuha**

Çdo palë shtyp tekstin dy herë në gjuhën e vet:

- a) në alternatin dhe në letrën e vet;
- b) në alternatin dhe në letrën e palës tjetër.

Palët mund të merren vesh që për çdo kopje origjinale të përdoret edhe një gjuhë e huaj e pranuar bashkërisht.

Pas kësaj këmbehen alternatet e shkronjës "b" të paragrafit 1 të këtij neni. Në këtë mënyrë secila palë ka dy kopje të ekzemplarit të vet në gjuhën e të dyja palëve.

Në raste të veçanta traktatet ndërkombëtare dypalëshe mund të hartohen edhe vetëm në një gjuhë të huaj të tretë, të pranuar bashkërisht nga të dyja palët. Në këtë rast dikasteri përkatës do të depozitojë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, krahas origjinalit të marrëveshjes, edhe përkthimin zyrtar në shqip të saj.

#### Neni 13

Ekzemplari i palës sonë shtypet në letër me kornizë të kuqe dhe lidhet në një dosje të posaçme me ngjyrë të kuqe, në qendër të së cilës është vendosur emblema e Republikës së Shqipërisë, me shirit kuq e zi dhe vuloset me vulat përkatëse të palës sonë dhe të palës tjetër.

#### Neni 14

Kur palët merren vesh që traktati ose marrëveshja të lidhet me shkëmbim notash, teksti autentik në një gjuhë të huaj, të pranuar bashkërisht, përfshihet në përmbajtjen e notave. Secila palë përpilon notën në alternatin e saj.

#### Neni 15

Kur përfaqësuesi i shtetit që merr pjesë në sesionet e organizatave ndërkombëtare ose në konferencat ndërkombëtare ngarkohet të nënshkruajë me rezervë traktatin ose marrëveshjen shumëpalëshe, apo të bëjë deklaratatë, teksti i rezervave ose i deklaratave miratohet më parë nga Këshilli i Ministrave.

Miratimi i rezervave për një traktat ndërkombëtar shumëpalësh ndjek të njëjtën procedurë që ndiqet për aderimin a ratifikimin e tij.

#### Neni 16

##### **Hyrja në fuqi e traktateve**

Traktatet ose marrëveshjet hyjnë në fuqi, sipas rastit, ditën e nënshkrimit të tyre ose në një datë të caktuar që përmendet shprehimisht në tekst, pas miratimit ose pas ratifikimit të tyre, në përputhje me normat ligjore në fuqi.

#### Neni 17

Ratifikimi, aderimi, miratimi dhe denoncimi i traktateve bëhet me ligj nga Kuvendi Popullor, me dekret të Presidentit të Republikës ose me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin kushtetues.

Presidenti i Republikës ratifikon, vendos aderimin dhe denoncon traktatet që nuk i shqyrton Kuvendi Popullor, sipas përcaktimit të bërë nga ligji kushtetues.

Këshilli i Ministrave miraton dhe denoncon marrëveshjet që nuk i nënshtrohen ratifikimit, por që përmbajnë klauzolen e miratimit. Këshilli i Ministrave jep miratimin për denoncimin nga ministritë dhe institucionet e tjera të marrëveshjeve të nënshkruara në emër të tij.

Presidenti i Republikës nënshkruan instrumentet e ratifikimit, të aderimit ose të denoncimit dhe Ministri i Punëve të Jashtme i kundërfirmon ato.

#### Neni 18

Instrumentet e ratifikimit të traktateve dypalëshe përmbajnë tekstin përkatës të tyre në gjuhët e përdorura nga palët e interesuara, si edhe numrin dhe datën e dekretit të ratifikimit.

#### Neni 19

Instrumentet e ratifikimit dhe të aderimit në traktatet dypalëshe dhe shumëpalëshe përgatiten nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe dërgohen, sipas rastit, në destinacionin e kërkuar.

Instrumentet e denoncimit të traktateve dypalëshe nuk përmbajnë tekstin, por vetëm titullin, datën dhe vendin ku është nënshkruar traktati, si dhe numrin dhe datën e dekretit të denoncimit të tij.

Instrumentet e ratifikimit, të aderimit dhe të denoncimit të traktateve shumëpalëshe që adoptohen nga organizatat ndërkombëtare ose nga konferencat ndërkombëtare, nuk përmbajnë tekstin, por vetëm titullin, datën, vendin dhe organizatën ndërkombëtare që ka adoptuar traktatin shumëpalësh, si dhe numrin dhe datën e dekretit të ratifikimit, aderimit ose të denoncimit.

Në instrumentet e ratifikimit ose të aderimit përfshihen edhe rezervat ose deklaratat që bëhen eventualisht për nene të caktuara.

Instrumentet e ratifikimit, aderimit dhe denoncimit të traktateve shumëpalëshe që adoptohen nga organizatat ndërkombëtare ose nga konferencat ndërkombëtare, u bashkëngjitet kopja e përkthyer dhe e vërtetuar në një gjuhë të huaj të pranuar bashkërisht.

#### Neni 20

Instrumentet e ratifikimit për traktatet dypalëshe i dorëzohen në një datë të caktuar përfaqësuesit të plotfuqishëm të shtetit të interesuar.

Instrumentet e ratifikimit, të aderimit dhe të denoncimit të traktateve shumëpalëshe që adoptohen nga organizatat ndërkombëtare ose nga konferencat ndërkombëtare, depozitohen pranë sekretariatit të organizatës përkatëse ose pranë organit të caktuar nga shteti që kryen funksionet e shtetit depozitar.

## Neni 21

Përfaqësuesi i shtetit, që ngarkohet të shkëmbejë instrumentet e ratifikimit me përfaqësuesin e plotfuqishëm të shtetit të interesuar, nënshkruan protokollin që hartohet për këtë qëllim në dy alternate, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e palës tjetër.

Në marrëveshje me palëve të interesuara protokollin mund të hartohet në një gjuhë të huaj të përbashkët me dy alternate.

## Neni 22

Ministria e Punëve të Jashtme është depozituese e traktateve dhe marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe. Ekzemplari origjinal depozitohet nga dikasteri përkatës në Ministrinë e Punëve të Jashtme së bashku me relacionin shpjegues dhe vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin në parim të traktatit ose marrëveshjes brenda një muaji nga data e nënshkrimit.

## Neni 23

Ministria e Punëve të Jashtme i paraqet Këshillit të Ministrave aktet (relacion, projektligj ose projektvendim) për ratifikimin, aderimin ose miratimin e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare brenda një muaji nga data e depozitimit të këtyre të fundit.

Këshilli i Ministrave i paraqet Kuvendit Popullor projektligjin, së bashku me relacionin përkatës, për ratifikimin ose aderimin në traktatet dhe marrëveshjet që përmbajnë klauzolën e ratifikimit a të aderimit dhe miraton marrëveshjet që përmbajnë klauzolën e miratimit.

Ratifikimi, aderimi dhe miratimi i traktateve dhe marrëveshjeve i njoftohet me notë palës tjetër dhe, kur kjo e fundit njofton zyrtarisht për ratifikimin, aderimin dhe miratimin e saj, Ministria e Punëve të Jashtme u dërgon ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore të interesuara një kopje të traktatit a marrëveshjes.

## Neni 24

### **Procedura e përgatitjes së plotfuqive, instrumenteve të ratifikimit, aderimit dhe protokolleve të shkëmbimit të tyre**

Plotfuqitë për përfaqësuesit e shtetit, që ngarkohen të zhvillojnë bisedime dhe të nënshkruajnë traktate ose marrëveshje, përgatiten nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Të gjitha plotfuqitë hartohen në gjuhën shqipe dhe atyre mund t'u bashkëngjitet kopja e vërtetuar, e përkthyer në një gjuhë të huaj.

## Neni 25

Plotfuqitë, ekzemplarët origjinalë të traktateve dhe të marrëveshjeve, instrumentet e ratifikimit, të aderimit, të denoncimit, si edhe protokollin e shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit vulosen me vulat zyrtare përkatëse.

Plotfuqitë, që nënshkruhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe në çdo rast të kundërfirmuara nga ministri i Punëve të Jashtme, si dhe instrumentet e ratifikimit, të aderimit dhe denoncimit, vulosen me vulën e thatë të shtetit.

Plotfuqitë që lëshohen nga titullarët e ministrive ose të institucioneve të tjera qendrore vulosen me vulën e njomë të ministrisë ose të institucionit përkatës.

Traktatet dhe marrëveshjet dypalëshe vulosen me vulën e thatë të Ministrisë së Punëve të Jashtme kur lidhen në vend dhe me vulën e thatë të përfaqësisë diplomatike kur nënshkruhen jashtë shtetit.

Traktatet dhe marrëveshjet, që lidhen me ato shtete ku nuk ka përfaqësi diplomatike, vulosen me vulën e thatë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të cilën e merr me vete delegacioni i ngarkuar për këtë qëllim.

Protokollet e shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit vulosen me vulën e njomë të Ministrisë së Punëve të Jashtme kur bëhen në vend dhe me vulën e njomë të përfaqësisë diplomatike kur bëhen jashtë shtetit.

#### Neni 26

#### **Ndjekja e zbatimit të traktateve ose marrëveshjeve**

Ministritë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit lokal të interesuara ndjekin zbatimin e traktateve e të marrëveshjeve ndërkombëtare të sektorit të tyre dhe informojnë për këtë Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme me raporte periodike.

#### Neni 27

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të interesuara, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, studiojnë mundësinë e zgjatjes, të përsëritjes, ndryshimit ose denoncimit të traktateve dhe të marrëveshjeve dypalëshe, para mbarimit të afatit të tyre.

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të interesuara i paraqesin Këshillit të Ministrave propozimet përkatëse për zgjatjen, përsëritjen, ndryshimin ose denoncimin e marrëveshjeve dypalëshe.

Këshilli i Ministrave i paraqet Kuvendit Popullor ose Presidentit të Republikës propozimet përkatëse për zgjatjen, përsëritjen, ndryshimin dhe denoncimin e traktateve.

Pasi të jenë miratuar propozimet përkatëse, Ministria e Punëve të Jashtme u propozon zyrtarisht palëve të interesuara zgjatjen, përsëritjen ose ndryshimin e traktateve a të marrëveshjeve dypalëshe.

Kur vendoset denoncimi i traktateve ose i marrëveshjeve dypalëshe, Ministria e Punëve të Jashtme njofton zyrtarisht palën e interesuar. Në rast denoncimi të një traktati ose të një marrëveshje shumëpalëshe, Ministria e Punëve të Jashtme njofton zyrtarisht, sipas rastit, organizatën ndërkombëtare përkatëse ose shtetin depozitar dhe ngarkon përfaqësuesin e vet të depozitojë për këtë qëllim instrumentin e denoncimit.

#### Neni 28

Ky ligj nuk ka fuqi prapavepruese lidhur me traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura para hyrjes në fuqi të tij. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet rregullorja për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, miratuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me vendimin nr.243, datë, 27.1.1978, ndryshuar me vendimin nr.292, datë 21.1.1983.

#### Neni 29

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerre aktet nënligjore përkatëse në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

#### Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.2161, datë 21.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

